



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Datë/a:	10.02.2021
Referenc-ë:	07-353/04-27088/22
Për/ Za/ To:	OJQ "Replay Peace"
Përmes/Preko/Through:	Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloji: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtorja për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtimit ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-27088/22 nga OJQ "Replay Peace" me përfaqësues Burim Krasniqit të cilët kërkojnë shfrytëzimin e hapësirës publike në sheshin "Skënderbeu" me datë 03.07.2022 nga ora 09:00 deri në 10:00.

Qëllimi i kërkesës është organizimi i Mini maratonës 5km me moton "Vrapo për shëndet të mirë" duke ndihmuar fëmijët me Autizëm të gjithë numrat që do të shiten atyre ju dedikohen. Në mini maratonë do të ftohen FSK, KFOR, Policia e Kosovës, Sportistë, Artistë dhe personalitete të njohura politike brenda dhe jashtë vendit.

Drejtorja pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për "Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike" me nr.01-110-157481, jep pëlqimin OJQ "Replay Peace" me përfaqësues Burim Krasniqi për shfrytëzimin e hapësirës publike sheshi "Skënderbeu" me datë 03.07.2022 nga ora 09:00 deri në 10:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Nuk lejohet dëmtimi i pronës publike dhe çdo dëmtim eventual si pasojë e këtij aktiviteti do të jetë përgjegjësi e juaja;
- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi;
- Mos të pengohet lëvizja e lirë e qytetarëve.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.